



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

**PROJEKTLIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-034 PËR MBROJTJEN
E KONSUMATORIT¹**

**DRAFT LAW ON AMENDING AND SUPPLEMENTING THE LAW NO. 06/L-034 ON CONSUMER
PROTECTION²**

NACRT ZAKONA O IZMENAMA I DOPUNAMA ZAKONA BR. 06/L-034 O ZAŠTITI POTROŠAČA³

¹ Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-034 Për Mbrojtjen e Konsumatorit është miratuar në mbledhjen e 102-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 04/102, të datës 26.10.2022.

² Draft Law on amending and supplementing the Law No. 06/L-034 on Consumer Protection was approved on the 102nd meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No. 04/102, dated 26.10.2022.

³ Nacrt Zakona o izmenama i dopunama Zakona Br. 06/L-034 o Zaštiti Potrošača usvojen je na 102 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br. 04/102, datum 26.10.2022.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-034 PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT</p> <p>Neni 1</p> <p>Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 06/L-34 për Mbrojtjen e Konsumatorit (në tekstin e mëtejme: Ligji).</p> <p>Neni 2</p> <p>Në nenin 1, paragrafi 2 të ligjit bazë shtohet nën-paragrafi 2.10 me tekstin si në vijim:</p> <p>„2.10. Direktiva (BE) 2019/2161 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 nëntor 2019 që ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13/EEC dhe Direktivat 98/6/EC, 2005/29/EC dhe 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosovo</p> <p>Based on Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Adopts:</p> <p>LAW ON AMENDING AND SUPPLEMENTING THE LAW NO. 06/L-034 ON CONSUMER PROTECTION</p> <p>Article 1</p> <p>Purpose</p> <p>The purpose of this Law shall be to amend and supplement the Law No. 06/L-34 on Consumer Protection (hereinafter ‘the Law’).</p> <p>Article 2</p> <p>Subparagraph 2.10 with the following text shall be added to Article 1, paragraph 2 of the basic law:</p> <p>2.10. Directive (EU) 2019/2161 of the European Parliament and of the Council of 27 November 2019 amending Council Directive 93/13/EEC and Directives 98/6/EC, 2005/29/EC and 2011/83/EU of</p>	<p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>U skladu sa članom 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ZAKONA O IZMENAMA I DOPUNAMA ZAKONA BR. 06/L-034 O ZAŠTITI POTROŠAČA</p> <p>Član 1</p> <p>Cilj</p> <p>Cilj ovog Nacrt zakona su izmene i dopune ZAKONA BR. 06/L-34 o zaštiti potrošača (u daljem tekstu „Zakon“).</p> <p>Član 2</p> <p>U članu 1 stav 2 osnovnog zakona dodaje se tačka 2.10 sa sledećim tekstom:</p> <p>2.10. Direktiva (EU) 2019/2161 Evropskog parlamenta i Saveta od 27. novembra 2019. o izmeni Direktive Saveta 93/13/EEZ i Direktiva 98/6/EZ, 2005/29/EZ i 2011/83/EU Evropskog parlamenta i Saveta</p>
---	--	---

<p>Këshillit për sa i përket zbatimit dhe modernizimit më të mirë të rregullave të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e konsumatorëve.“</p>	<p>the European Parliament and of the Council as regards the better enforcement and modernisation of Union consumer protection rules.</p>	<p>u pogledu boljeg izvršavanja i modernizacije pravila Evropske unije o zaštiti potrošača.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3</p>	<p style="text-align: center;">Article 3</p>	<p style="text-align: center;">Član 3</p>
<p>Në nenin 2 të ligjit bazë shtohen paragrafët 3, 4 dhe 5, me tekstet si në vijim:</p>	<p>Paragraphs 3, 4 and 5 with the following texts shall be added to Article 2 of the basic law:</p>	<p>U članu 2 odnosnog zakona dodaju se stavovi 3, 4. i 5 sa sledećim tekstovima:</p>
<p>„3. Ky Ligj do të zbatohet për çdo kontratë të lidhur ndërmjet një tregtari dhe një konsumatori ku konsumatori paguan ose merr përsipër të paguajë çmimin. Ligji do të zbatohet për kontratat për furnizimin me ujë, gaz, energji elektrike ose ngrohje qendrore, përfshirë ato nga ofruesit publikë, në masën që këto të mira ofrohen në bazë kontraktuale.</p>	<p>3. This Law shall apply to any contract entered into between a trader and a consumer where the consumer pays or undertakes to pay the price. The law will apply to contracts for the supply of water, gas, electricity or central heating, including those from public providers, to the extent that these goods are offered on a contractual basis.</p>	<p>3. Ovaj zakon primenjuje se na svaki ugovor zaključen između trgovca i potrošača u kome potrošač plaća ili se obavezuje da će platiti cenu. Zakon će se primenjivati na ugovore o snabdevanju vodom, gasom, električnom energijom ili centralnim grejanjem, uključujući i one od javnih provajdera, u meri u kojoj se ta dobra nude na osnovu ugovora.</p>
<p>4. Ky ligj zbatohet gjithashtu kur tregtari furnizon ose merr përsipër të furnizojë përmbajtje digjitale e cila nuk është furnizuar në një medium të prekshëm ose një shërbim digjital për konsumatorin dhe konsumatori siguron ose merr përsipër të sigurojë të dhëna personale tregtarit, përveç kur të dhënat personale të siguruara nga konsumatori përpunohen ekskluzivisht nga tregtari për qëllimin e furnizimit me përmbajtje digjitale e cila nuk është furnizuar në një medium të prekshëm ose shërbim digjital në përputhje me këtë ligj ose për të lejuar që tregtari të veprojë</p>	<p>4. This Law shall also apply where the trader supplies or undertakes to supply digital content which is not supplied on a tangible medium or a digital service to the consumer and the consumer provides or undertakes to provide personal data to the trader, except where the personal data provided by the consumer are exclusively processed by the trader for the purpose of supplying the digital content which is not supplied on a tangible medium or digital service in accordance with this Directive or for allowing the trader to comply with legal</p>	<p>4. Ovaj zakon se takođe primenjuje kada trgovac isporučuje ili se obavezuje da će potrošaču isporučiti digitalni sadržaj koji nije isporučen u fizičkom mediju ili digitalnoj usluzi, a potrošač obezbeđuje ili se obavezuje da obezbedi lične podatke trgovcu, osim kada su lični podaci koji su obezbeđeni od potrošača obrađeni isključivo od strane trgovca u cilju isporuke digitalnog sadržaja koji nije isporučen u fizičkom mediju ili digitalnoj usluzi u skladu sa ovim zakonom, ili da bi omogućio trgovcu da postupa u skladu sa zakonskim uslova</p>

<p>në përputhje me kërkesat ligjore për të cilat tregtari është subjekt, dhe tregtari nuk i përpunon ato të dhëna për ndonjë qëllim tjetër.</p> <p>5. Pa paragjykuar paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, ky ligj nuk zbatohet te kontratat që kanë të bëjnë me:</p> <p>5.1. shërbimet sociale;</p> <p>5.2. shërbimet shëndetësore;</p> <p>5.3. lojërat e fatit;</p> <p>5.4. shërbimet financiare;</p> <p>5.5. krijimin, blerjen apo transferimin e pronës së paluajtshme ose të drejtave në pronën e paluajtshme;</p> <p>5.6. ndërtimin e objekteve të reja, konvertimit të konsiderueshëm të ndërtesave ekzistuese dhe karshi akomodimeve me qira për qëllime banimi;</p> <p>5.7. udhëtimet dhe pushimet në formë paketash turistike brenda fushëveprimit të ligjit përkatës për Turizëm dhe Shërbime turistike;</p> <p>5.8. në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës, të hartuara nga autoritetet publike që kanë detyrimin ligjor për të</p>	<p>requirements to which the trader is subject, and the trader does not process those data for any other purpose.’</p> <p>5. Without prejudice to paragraphs 3 and 4 of this Article, this Law shall not apply to contracts relating to:</p> <p>5.1. social services;</p> <p>5.2. health services;</p> <p>5.3. gambling;</p> <p>5.4. financial services;</p> <p>5.5. the creation, acquisition or transfer of immovable property or of rights in immovable property;</p> <p>5.6. the construction of new buildings, the substantial conversion of existing buildings and for rental of accommodation for residential purposes;</p> <p>5.7. package travel and package holidays that fall within the scope of respective Law on Tourism and Touristic Services;</p> <p>5.8. in accordance with the laws of the Republic of Kosovo, drafted by relevant public authorities, which</p>	<p>kojima podleže trgovac, a trgovac ne obrađuje te podatke u bilo koju drugu svrhu.</p> <p>5. Bez prejudiciranja stavova 3 i 4 ovog člana, ovaj zakon se ne primenjuje za ugovore koji se odnose na:</p> <p>5.1. socijalne usluge;</p> <p>5.2. zdravstvene usluge;</p> <p>5.3. igre na sreću;</p> <p>5.4. finansijske usluge;</p> <p>5.5. stvaranje, kupovinu ili prenos nepokretne imovine ili imovinska prava na nepokretnu imovinu;</p> <p>5.6. izgradnja novih objekata, značajnu promene namene postojećih zgrada i u odnosu na iznajmljivanje smeštaja u cilju stanovanja;</p> <p>5.7. putovanja i odmore u vidu turističkih aranžmana u okviru delokruga relevantnog zakona o turizmu i turističkim uslugama;</p> <p>5.8. u skladu sa zakonima Republike Kosovo, koje su izradili javni organi koji imaju zakonsku obavezu da budu nezavisni, nepristrasni i sigurni,</p>
---	---	---

<p>qenë të pavarur, paanshëm dhe të sigurt, duke ofruar informacion të kuptueshëm ligjor, që konsumatori arrin kontratën vetëm në bazë të konsideratës së kujdesshme ligjore dhe përmes njohurisë së fushëveprimit ligjor;</p> <p>5.9. furnizimin e ushqimeve, pijeve ose mallrave të tjera të destinuara për konsum aktual në familje, fizikisht të furnizuara nga tregtari brenda një rutine të rregullt dhe të shpeshtë në shtëpinë, vendbanimin ose vendin ku punon konsumatori;</p> <p>5.10. shërbimet e transportit të pasagjerëve, me përjashtim të paragrafit 2 të nenit 40, dhe neneve 52 dhe 55 të këtij ligji;</p> <p>5.11. aparatet apo premiset e automatizuara komerciale të shitjes;</p> <p>5.12. operatorët e telekomunikimit në relacion me përdorimin e telefonave publikë ose për përdorimin e një lidhje të vetme telefonike, interneti ose faksi të vendosur nga konsumatori;</p>	<p>has a statutory obligation to be independent and impartial in providing comprehensive legal information, so that the consumer concludes the contract on the basis of careful consideration and knowing their scope;</p> <p>5.9. the supply of foodstuffs, beverages or other goods intended for current consumption in the household, and which are physically supplied by a trader on frequent and regular rounds to the consumer's home, residence or workplace;</p> <p>5.10. passenger transport services, with the exception of paragraph 2. of Article 40 and Articles 52 and 55 of this Law;</p> <p>5.11. automatic vending machines or automated commercial premises;</p> <p>5.12. telecommunications operators through public payphones for their use or for the use of one single connection by telephone, internet or fax established by a consumer;</p>	<p>dajući razumljive pravne informacije, da potrošač dolazi do ugovora samo na osnovu pažljivog pravnog razmatranja i kroz znanje o pravnom delokrugu;</p> <p>5.9. nabavku prehrambenih proizvoda, pića ili druge robe namenjene sadašnjoj potrošnji u domaćinstvu, koje trgovac fizički isporučio u okviru redovne i česte rutine do kuće, mesta stanovanja ili radnog mesta potrošača;</p> <p>5.10. usluge prevoza putnika, izuzev stava 2 člana 40 i članova 52 i 55 ovog zakona;</p> <p>5.11. aparata ili automatizovanih prodajnih prostorija;</p> <p>5.12. operatera telekomunikacija u odnosu na korišćenje javnih telefona ili korišćenje jednog priključka telefonije, interneta ili faksa postavljenih od strane potrošača;</p>
--	---	---

<p>5.13. për çdo mall që shitet me anë të ekzekutimit ose ndryshe nga autoriteti ligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4</p> <p>1. Në nenin 3, nën-paragrafët 1.4, 1.31, 1.46 dhe 1.64 të ligjit bazë fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:</p> <p>1.4. Produkt – çdo e mirë, produkt ose shërbim duke përfshirë pasurinë e paluajtshme, shërbimin digjital dhe përmbajtjen digjitale, si dhe të drejtat dhe detyrimet;</p> <p>1.31. Kontratë shërbimi - çdo kontratë përveç kontratës së shitjes sipas së cilës tregtari furnizon ose merr përsipër të furnizojë një shërbim, përfshirë një shërbim digjital te konsumatori;</p> <p>1.46. Riparimi – në rast të mungesës së përputhshmërisë, mallrat e konsumit të sillen në konformitet me kontratën e shitjes;</p> <p>1.64. Ministria – ministria përkatëse për industri, ndërmarrësi dhe tregti.</p>	<p>5.13. for any goods sold by way of execution or otherwise by authority of law.</p> <p style="text-align: center;">Article 4</p> <p>1. Under Article 3, sub-paragraphs 1.4, 1.31, 1.46, 1.64 of the basic law shall be deleted and rephrased with the following text:</p> <p>1.4. Product - means any good or service including immovable property, digital service and digital content, as well as rights and obligations;</p> <p>1.31. Service contract - any contract other than the sales contract under which the trader supplies or undertakes to provide a service, including a digital service to the consumer;</p> <p>1.46. Repair – in the event of lack of conformity, bringing consumer goods into conformity with the sales contract;</p> <p>1.64. Ministry - the relevant Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade.</p>	<p>5.13. za svaku robu koja se prodaje izvršenjem ili na drugi način, od strane pravosudnog organa.</p> <p style="text-align: center;">Član 4</p> <p>1. U članu 3 stavovi 1.4, 1.31, 1.46, 1.64 osnovnog zakona brišu se i preformulišu sledećim tekstem:</p> <p>1.4. Proizvod – svako dobro, proizvod ili usluga, uključujući nepokretnu imovinu, digitalnu uslugu i digitalni sadržaj, kao i prava i obaveze;</p> <p>1.31. Ugovor o pružanju usluga – svaki ugovor osim ugovora o prodaji, putem kojeg trgovac isporučuje ili se obavezuje da isporučuje potrošaču jednu uslugu, uključujući digitalnu uslugu;</p> <p>1.46. Popravka – u slučaju nedostatka usaglašenosti, roba široke potrošnje se dovodi u usaglašenost putem ugovor o prodaji;</p> <p>1.64. Ministarstvo – relevantno ministarstvo industrije, preduzetništva i trgovine.</p>
--	--	---

<p>2. Në nenin 3, paragrafi 1, pas nën-paragrafit 1.64 të ligjit bazë, shtohen nën-paragrafët 1.65, 1.66, 1.67, 1.68, 1.69, 1.70, 1.71, 1.72, 1.73, 1.74, 1.75, 1.76, 1.77 dhe 1.78 si në vijim:</p> <p>1.65. Kontrata ndihmëse te kontratat e pushimit me afat, afatgjatë, rishitjes dhe shkëmbimit – një kontratë që lidhet me kontratën kryesore por është në varësi të saj. Nëse një klient anulon kontratën kryesore, kontrata shtesë anulohet automatikisht dhe është përgjegjësi e tregtarit të njoftojë çdo palë përkatëse;</p> <p>1.66. Rangimi – rëndësia relative e produkteve, siç prezantohen, organizohen ose komunikohen nga tregtari, pavarësisht nga mjetet teknologjike të përdorura për prezantimin, organizimin ose komunikimin e tillë;</p> <p>1.67. Treg në internet – një shërbim që përdor softuer, përfshirë ueb-faqe në internet, ueb-faqe të përsëritshëm ose një aplikacion, që përdoret nga ose për llogari të një tregtari që lejon konsumatorët të lidhin kontrata në distancë me tregtarë ose konsumatorë të tjerë;</p>	<p>2. Under Article 3, paragraph 1, after subparagraph 1.64 of the basic law, subparagraphs 1.65, 1.66, 1.67, 1.68, 1.69, 1.70, 1.71, 1.72, 1.73, 1.74, 1.75, 1.76, 1.77 and 1.78 shall be added as follows:</p> <p>1.65. Ancillary contracts to term, long-term, resale and exchange contracts - a contract relating to the principal contract but is dependent on it. If a customer cancels the principal contract, the additional contract shall be automatically canceled and it shall be the trader's responsibility to notify each party concerned;</p> <p>1.66. Ranking - the relative importance of the products as presented, organized or communicated by the trader, regardless of the technological means used for such presentation, organization or communication;</p> <p>1.67. Online market - a service that uses software, including a website, a recurring website or an application, used by or on behalf of a trader enabling consumers to enter into distance contracts with the traders or other consumers;</p>	<p>2. U članu 3 stav 1 nakon tačke 1.64 osnovnog zakona, dodaju se tačke 1.65, 1.66, 1.67, 1.68, 1.69, 1.70, 1.71, 1.72, 1.73, 1.74, 1.75, 1.76, 1.77 i 1.78 kao u nastavku:</p> <p>1.65. Pomoćni ugovori kod oročenih, dugoročnih i ugovora o preprodaji i razmeni – ugovor koji je se zaključuje sa glavnim ugovorom, ali je zavisan od njega. Ako kupac otkaže glavni ugovor, dodatni ugovor se automatski poništava i trgovac je dužan da obavesti svaku zainteresovanu stranu;</p> <p>1.66. Rangiranje - relativna važnost proizvoda, kako ih je predstavio, organizovao ili saopštio trgovac, bez obzira na tehnološka sredstva koja se koriste za takvu prezentaciju, organizaciju ili saopštavanje;</p> <p>1.67. Internet tržište – usluga koja koristi softver, uključujući internet stranicu na vebu, internet stranicu ili aplikaciju koja se ponavlja, koju se koristi od ili u ime trgovca, a koja omogućava potrošačima da zaključuju ugovore na daljinu sa trgovcima ili drugim potrošačima;</p>
--	--	--

<p>1.68. Mallrat –</p> <p>(a) çdo send i luajtshëm dhe i prekshëm; uji, gazi dhe energjia elektrike duhet të konsiderohen si mallra sipas këtij ligji, kur ato janë vendosur për shitje në një vëllim të kufizuar ose një sasi të caktuar;</p> <p>(b) çdo send i luajtshëm dhe i prekshëm që përfshin ose është i ndërlidhur me përmbajtje digjitale ose një shërbim digjital në mënyrë të tillë që mungesa e asaj përmbajtje digjitale ose shërbimi digjital të parandalojë mallrat të kryejnë funksionet e tyre (mallrat me elemente digjitale);</p> <p>1.69. Të dhënat personale - çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm subjekt i të dhënave. Një person fizik i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një identifikuesi të tillë si një emër, një numri identifikimi, të dhënave të vendëndodhjes, një identifikuesi në internet ose një ose më shumë faktorëve specifik fizik, fiziologjik, identiteti, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror të atij personi fizik;</p>	<p>1.68. Goods –</p> <p>(a) any movable and tangible item; water, gas and electricity must be considered as goods under this Law when they are put up for sale in a limited volume or a certain quantity;</p> <p>(b) any movable and tangible item that includes or is associated with digital content or a digital service in such a way that the absence of such digital content or digital service prevents the goods from performing their functions ('goods with digital elements');</p> <p>1.69. Personal data - any information relating to an identified or identifiable natural person being the 'data subject'. An identifiable natural person shall be the one who can be identified, directly or indirectly, in particular by referring to an identifier such as a name, an identification number, location data, an Internet identifier or one or more specific physical, physiological, identity, genetic, mental, economic, cultural or social factor of that natural person;</p>	<p>1.68. Roba –</p> <p>(a) svaka pokretna i opipljiva stvar; voda, gas i električna energija prema ovom zakonu trebaju se smatrati robom, kada se ona stavlja na prodaju u ograničenom obimu ili određenoj količini;</p> <p>(b) svaka pokretna i opipljiva stvar koja uključuje ili je povezana sa digitalnim sadržajem ili digitalnom uslugom na takav način da odsustvo takvog digitalnog sadržaja ili digitalne usluge sprečava robu da obavlja svoje funkcije („roba sa digitalnim elementima“);</p> <p>1.69. Lični podaci – svaka informacija o identifikovanom fizičkom licu ili koje može biti identifikovani kao „predmet podataka“. Fizičko lice koje može biti identifikovano je ono koje se može identifikovati, direktno ili indirektno, posebno pozivajući se na identifikator kao što je ime, identifikacioni broj, podaci o lokaciji, identifikator na internetu ili jedan ili više specifičnih fizičkih, fizioloških, identitetskih, genetskih, mentalnih, ekonomskih, kulturnih ili socijalnih faktora tog fizičkog lica;</p>
--	--	--

<p>1.70. Kontrata e shitjes – çdo kontratë sipas së cilës tregtari transferon ose merr përsipër të transferojë pronësinë e mallrave të konsumatori, përfshirë çdo kontratë që ka si objekt të saj mallrat dhe shërbimet;</p> <p>1.71. Mallra me elemente digjitale – sende të prekshme dhe të luajtshme që përmbajnë ose janë të ndërlidhura me përmbajtjen digjitale ose një shërbim digjital në mënyrë të tillë që mungesa e asaj përmbajtjeje digjitale ose shërbimit digjital do të pengonte mallrat të kryejnë funksionet e tyre;</p> <p>1.72. Treg elektronik – një shërbim që përdor softuerin, përfshirë faqen në internet, qoftë edhe pjesërisht një faqe në internet ose një aplikacion, të operuar nga ose për llogari të një tregtari që lejon konsumatorët të lidhin kontrata në distancë me tregtarë ose konsumatorë të tjerë;</p> <p>1.73. Ofruesi i një tregu në formë elektronike – çdo tregtar i cili siguron një treg në internet për konsumatorët;</p> <p>1.74. Përputhshmëria – aftësia e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital për të funksionuar me harduer ose softuer me të cilin përdoren</p>	<p>1.70. Sales contract - any contract under which the trader transfers or undertakes to transfer ownership of goods to the consumer, including any contract having as its object both goods and services;;</p> <p>1.71. Goods with digital elements - tangible and movable items containing or relating to digital content or a digital service in such a way that the absence of such digital content or digital service would prevent the goods from performing their functions;</p> <p>1.72. Electronic market - a service that uses software, including a website, whether in part a website or an application, operated by or on behalf of a trader enabling consumers to enter into distance contracts with the traders or other consumers;</p> <p>1.73. Electronic form market provider - any trader which provides an online marketplace to consumers;</p> <p>1.74. Compatibility - the ability of digital content or digital services to operate with the hardware or software whereby the digital content</p>	<p>1.70. Ugovor o prodaji - svaki ugovor putem kojeg trgovac prenosi ili se obavezuje da prenese potrošaču vlasništvo nad robom, uključujući svaki ugovor čiji je predmet roba i usluge;</p> <p>1.71. Roba sa digitalnim elementima - materijalne i pokretne stvari koje sadrže ili su povezane sa digitalnim sadržajem ili digitalnom uslugom na takav način da odsustvo tog digitalnog sadržaja ili digitalne usluge ometa robu da obavlja svoje funkcije;</p> <p>1.72. Elektronsko tržište – usluga koja koristi softver, uključujući internet stranicu, bilo da je delimično internet stranica ili aplikacija, kojom upravlja trgovac ili u njegovo ime, a koja omogućava potrošačima da zaključuju ugovore na daljinu sa trgovcima ili drugim potrošačima;</p> <p>1.73. Provajder elektronskog tržišta - svaki trgovac koji potrošačima obezbeđuje internet tržište;</p> <p>1.74. Usaglašenost – sposobnost digitalnog sadržaja ili digitalne usluge da rade sa hardverom ili softverom koji normalno koristi</p>
---	---	---

<p>normalisht përmbajtja digjitale ose shërbimet digjitale të të njëjtit lloj, pa nevojën e konvertimit të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital;</p> <p>1.75. Përmbajtje digjitale – nënkupton të dhënat që prodhohen dhe ofrohen në formë digjitale;</p> <p>1.76. Shërbim digjital –</p> <p>(a) një shërbim që lejon konsumatorin të krijojë, përpunojë, ruajë ose qasje te të dhënat në formë digjitale; ose</p> <p>(b) një shërbim që lejon ndarjen ose çdo ndërveprim tjetër me të dhënat në formë digjitale të ngarkuara ose të krijuara nga konsumatori ose përdoruesit e tjerë të atij shërbimi;</p> <p>1.77. Funksionaliteti – aftësia e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital për të kryer funksionet duke pasur parasysh qëllimin e tij;</p> <p>1.78. Ndërveprimi – aftësia e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital për të funksionuar me pajisje ose softuer të ndryshëm nga ato me të cilat përdoren zakonisht në relacion me përmbajtjen digjitale ose shërbimet digjitale të të njëjtit lloj.</p>	<p>or digital services of the same type are normally used, without the need to convert digital content or digital services;</p> <p>1.75. Digital content - means data that is produced and provided in digital form;</p> <p>1.76. Digital service -</p> <p>(a) a service enabling the consumer to generate, process, store or access data in digital form; or</p> <p>(b) a service enabling the sharing or any other interaction with data in digital form uploaded or generated by the customer or other users of that service;</p> <p>1.77. Functionality - the ability of the digital content or digital service to perform the functions taking into account its purpose;</p> <p>1.78. Interoperability - the ability of digital content or digital services to operate with devices or software other than those commonly used in relation to digital content or digital services of the same type.</p>	<p>digitalni sadržaj ili digitalne usluge iste vrste, bez potrebe za konverzijom digitalnog sadržaja ili digitalnih usluga;</p> <p>1.75. Digitalni sadržaj – znači svi podaci koji se proizvedu ili pružaju u digitalnom obliku;</p> <p>1.76. Digitalna usluga –</p> <p>(a) usluga koja omogućava potrošaču da kreira, obrađuje, čuva ili pristupa podacima u digitalnom obliku; ili</p> <p>(b) usluga koja omogućava distribuciju ili bilo koju drugu interakciju sa podacima u digitalnom obliku, koje je postavio ili kreirao potrošač ili drugi korisnici te usluge;</p> <p>1.77. Funkcionalnost – sposobnost digitalnog sadržaja ili digitalne usluge da obavlja funkcije uzimajući u obzir njegovu namenu;</p> <p>1.78. Interakcija – sposobnost digitalnog sadržaja ili digitalne usluge da funkcionišu sa uređajima ili softverom koji se razlikuju od onih koji se obično koriste u vezi sa digitalnim sadržajem ili digitalnim uslugama iste vrste.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 5</p> <p>1. Në nenin 4 të ligjit bazë shtohet nën-paragrafi 1.10 me tekstin si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.10. E drejta e konsumatorit për trajtim të barabartë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 5</p> <p>1. In Article 4 of the basic law is added sub-paragraph 1.10 with the following text:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.10. Consumer right to equal treatment and protection against discrimination.</p>	<p style="text-align: center;">Član 5</p> <p>1. U članu 4 bazičnog zakona dodaje se podstav 1.10 koji glasi:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.10. Pravo potrošača na jednak tretman i zaštitu od diskriminacije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6</p> <p>1. Në nenin 7, pas paragrafit 3 të ligjit bazë shtohet paragrafi 4 dhe formulohet me tekstin si në vijim:</p> <p>4. Ndalohet diskriminimi i konsumatorit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 6</p> <p>1. In Article 7 after paragraph 3 of the basic law, paragraph 4 is added and formulated with the following text:</p> <p>4. It is prohibited to discriminate against the consumer on the basis of nationality or affiliation with any community, social or national origin, race, ethnicity, color, birth, origin, sex, gender, gender identity, sexual orientation, language, citizenship, religion and belief, political affiliation, political or other opinion, social or personal status, age, family or marital status, pregnancy, maternity, property status, health status, disability, genetic inheritance or any other basis, in order to apply the principle of equal treatment.</p>	<p style="text-align: center;">Član 6</p> <p>1. U članu 7 posle stava 3 osnovnog zakona dodaje se stav 4 i formuliše sledeći tekst:</p> <p>4. Zabranjena je diskriminacija potrošača na osnovu nacionalnosti ili pripadnosti bilo kojoj zajednici, društvenog ili nacionalnog porekla, rase, etničke pripadnosti, boje kože, rođenja, porekla, pola, rodu, rodnog identiteta, seksualne orijentacije, jezika, državljanstva, veroispovesti i uverenja, političko opredeljenje, političko ili drugo mišljenje, društveni ili lični status, godine, bračno ili bračno stanje, trudnoća, materinstvo, imovinsko stanje, zdravstveno stanje, invaliditet, genetsko nasleđe ili bilo koji drugi osnov, u cilju primene principa jednak tretman.</p>

Neni 7	Article 7	Član 7
<p>1. Në nenin 8, nën-paragrafi 1.11 i ligjit bazë fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:</p> <p>1.11. Përdorimi i përmbajtjes editoriale në media për të promovuar një produkt aty ku tregtari ka paguar për promovim pa e bërë këtë të qartë në përmbajtje ose me imazhe apo shprehimhsht me zë qartësisht të identifikueshëm nga konsumatori.</p> <p>Sigurimi i rezultateve të kërkimit në përgjigje të kërkim-shpjegimeve nga konsumatorët përmes internetit pa shpalosur reklamime apo pagesa posaçërisht për arritjen e një rënditjeje më të lartë të produkteve brenda rezultateve të kërkimit;</p> <p>2. Në nenin 8, paragrafit 1 të ligjit bazë i shtohen nën-paragrafët 1.24, 1.25, dhe 1.26 me tekstet si në vijim:</p> <p>1.24. Rishitja e biletave të ngjarjeve konsumatorëve nëse tregtari i ka blerë ato duke përdorur mjete të automatizuara për të anashkaluar çdo kufi të vendosur në numrin e biletave që një person mund të blejë ose ndonjë rregull tjetër që zbatohet për blerjen e biletave;</p>	<p>1. Under Article 8, subparagraph 1. 11 of the basic law shall be deleted and rephrased by the following text:</p> <p>1.11. Using editorial content in the media to promote a product where the trader has paid for the promotion without making this clear in the content either by images or voice clearly identifiable by the consumer.</p> <p>Providing search results in response to online customer search-explanations without disclosing advertisements or payments specifically to achieve a higher ranking of products within the search results;</p> <p>2. Paragraphs 1.24, 1.25 and 1.26 with the following texts shall be added to Article 9, paragraph 1 of the basic law:</p> <p>1.24. Resale of consumer event tickets if the trader has purchased them using automated devices to circumvent any limit set on the number of tickets a person can purchase or any other rules that apply to ticket purchases;</p>	<p>1. U članu 8 tačka 1. 11 osnovnog zakona se briše i preformuliše sledećim tekstem:</p> <p>1.11. Korišćenje uredničkog sadržaja u medijima za promovisanje proizvoda tamo gde je trgovac platio za promovisanje bez jasnog navođenja u sadržaju, slikama ili na jasno prepoznatljivom glasu za potrošača.</p> <p>Obezbeđivanje rezultata pretrage kao odgovor na traženje objašnjenja od potrošača putem interneta bez otkrivanja reklama ili plaćanja posebno za postizanje višeg rangiranja proizvoda u rezultatima pretrage;</p> <p>2. U članu 8 stavu 1 osnovnog zakona dodaju se tačke 1.24, 1.25 i 1.26 sa sledećim tekstovima:</p> <p>1.24. Preprodaja karata potrošačima za događaje ako ih je prodavac kupio koristeći automatizovana sredstva da zaobiđe bilo koje ograničenje koje je postavljeno na broj karata koje jedna osoba može da kupi, ili bilo koja druga pravila koja se primenjuju na kupovinu karata;</p>

<p>1.25. përmes deklaramit që rishikimi i një produkti është ofruar nga konsumatorët që kanë përdorur ose blerë në të vërtetë produktin pa marrë hapa të arsyeshëm dhe proporcional për të verifikuar nëse ato vijnë nga konsumatorë të tillë;</p> <p>1.26. Angazhimi ose porositja e një personi tjetër juridik ose fizik për të dhënë vlerësime ose paraqitje të rreme ndaj konsumatorëve ose vërtetime sociale, me qëllim të promovimit të produkteve.</p>	<p>1.25. By stating that a review of a product has been provided by consumers who have actually used or purchased the product without taking reasonable and proportionate steps to verify whether they come from such consumers;</p> <p>1.26. Engaging or ordering another legal or natural person to give false customer evaluations or appearances or social certifications in order to promote products.</p>	<p>1.25. Putem deklaracije da recenzija proizvoda koji su nudili potrošači, koji su koristili ili zapravo kupili proizvod bez preduzimanja razumnih i proporcionalnih koraka da bi proverili da li proizvodi dolaze od takvih potrošača;</p> <p>1.26. Angažovanje ili isporučivanje drugog pravnog ili fizičkog lica da daje lažne ocene ili predstavlanje potrošača ili društvene sertifikate, u cilju promovisanja proizvoda.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8</p>	<p style="text-align: center;">Article 8</p>	<p style="text-align: center;">Član 8</p>
<p>Në nenin 9, paragrafi 3 të ligjit bazë shtohet nën-paragrafi 3.3 me tekstin si në vijim:</p>	<p>Subparagraph 3.3 with the following text shall be added to Article 9, paragraph 3 of the basic law:</p>	<p>1. U članu 9 stavu 3 osnovnog zakona dodaje se tačka 3.3 sa sledećim tekstem:</p>
<p>3.3. Çdo tregtim i mallit si identik me një mall të tregtuar në një vend tjetër, përderisa ai mall ka përbërje ose karakteristika dukshëm të ndryshme, përveç nëse arsyetohet nga faktorë legjitim dhe objektiv.</p>	<p>3.3. Any marketing of a good, in one Member State, as being identical to a good marketed in other Member States, while that good has significantly different composition or characteristics, unless justified by legitimate and objective factors.’;</p>	<p>3.3. Svako trgovanje robom kao identičnom robom kojom se trguje u drugoj zemlji, sve dok ta roba ima značajno drugačiji sastav ili karakteristike, osim ako je opravdana legitimnim i objektivnim faktorima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9</p>	<p style="text-align: center;">Article 9</p>	<p style="text-align: center;">Član 9</p>
<p>1. Në nenin 10, nën-paragrafi 4.4 i ligjit bazë fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:</p>	<p>1. Paragraph 4.4 of Article 10 of the basic law shall be deleted and rephrased as follows:</p>	<p>1. U članu 10 tačka 4.4 osnovnog zakona se briše i preformuliše sledećim tekstem:</p>

<p>4.4. Marrëveshjet për pagesa, dorëzim dhe performancë, nëse ato largohen nga kërkesat e kujdesit profesional;</p> <p>2. Në nenin 10, paragrafi 4, pas nën-paragrafit 4.5 të ligjit bazë shtohet nën-paragrafi 4.6 me tekstin si në vijim:</p> <p>4.6. Për produktet e ofruara në tregjet elektronike, pavarësisht nëse pala e tretë që ofron produktet është një tregtar apo jo, në bazë të deklaratës së asaj pale të tretë për ofruesin e tregut në internet.</p> <p>3. Në nenin 10, nën-paragrafi 5 i ligjit bazë fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:</p> <p>“5. Kërkesat e përcaktuara në relacion me komunikimin tregtar përfshi reklamimin apo marketingun, ku një listë jo e plotë do të rregullohet me akt nënligjor.”</p> <p>4. Në nenin 10 të ligjit bazë shtohen paragrafët 6 dhe 7 me tekstet si në vijim:</p> <p>“6. Kur konsumatorëve u ofrohet mundësia për të kërkuar për produktet e ofruara nga tregtarë të ndryshëm ose nga konsumatorët në bazë të një pyetjeje në formën e një fjale</p>	<p>4.4. Arrangements for payment, delivery and performance, if they avert from occupational care requirements;</p> <p>2. Subparagraph 4.6 with the following text shall be added to Article 10, paragraph 4, after sub-paragraph 4.5 of the basic law:</p> <p>4.6. For the products offered in the electronic markets, regardless of whether the third party offering the products is a trader or not, based on that third party’s statement to the online market provider.</p> <p>3. Paragraph 5 of Article 10 of the basic law shall be deleted and rephrased as follows:</p> <p>„5. Requirements set out in relation to commercial communication including advertising or marketing, where an incomplete list shall be regulated by a bylaw.“</p> <p>4. Paragraphs 6 and 7 with the following texts shall be added to Article 10 of the basic law:</p> <p>„6. When consumers are given the opportunity to search for products offered by different traders or consumers based on a query in the form of a</p>	<p>4.4. Ugovori o plaćanjima, isporuci ili učinku, ako su one uklonjene iz zahteva profesionalne nege;</p> <p>2. U članu 10 stavu 4 nakon tačke 4.5 osnovnog zakona, dodaje se tačka 4.6 sa sledećim tekstem:</p> <p>4.6. Za proizvode koji se nude na elektronskim tržištima, bez obzira na to da li je treće lice koja nudi proizvode trgovac ili ne, na osnovu izjave tog trećeg lica za provajdera na internet tržištu.</p> <p>3. U članu 10 stav 5 osnovnog zakona briše se i preformuliše sledećim tekstem:</p> <p>„5. Zahtevi postavljeni u vezi sa komercijalnom komunikacijom uključujući oglašavanje ili marketing, gde će nepotpuna lista biti regulisana podzakonskim aktom.“</p> <p>4. U članu 10 osnovnog zakona dodaju se stavovi 6 i 7 sa sledećim tekstovima:</p> <p>„6. Kada se potrošačima pruža mogućnost da pretražuju proizvode koje nude različiti trgovci ili potrošači na osnovu pitanja u obliku ključne reči, fraze ili druge</p>
---	--	--

<p>kyçe, fraze ose informacion tjetër, pavarësisht se ku apo kur arrihen përfundimisht transaksionet, informacioni i përgjithshëm, i disponueshëm në një seksion specifik në faqe në internet që është drejtpërdrejt dhe lehtësisht i arritshëm nga faqja ku paraqiten rezultatet e hulumtimit, mbi parametrat kryesorë që përcaktojnë renditjen e produkteve të paraqitura tek konsumatori si rezultat i pyetjes së kërkimit dhe rëndësisë relative të këtyre parametrave, në krahasim me parametrat e tjerë, do të konsiderohen si materiale. Ky paragraf nuk zbatohet për ofruesit e shërbimeve të kërkimit në internet.</p> <p>7. Kur një tregtar ofron qasje në rishikimet e produkteve të konsumatorëve, informacioni nëse dhe si tregtari siguron që komentet e publikuara vijnë nga konsumatorët që e kanë përdorur ose blerë produktin në të vërtetë, do të konsiderohet si material.“</p> <p style="text-align: center;">Neni 10</p> <p>Fshihet paragrafi 3 i nenit 17.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11</p> <p>Nenit 33 i shtohet paragrafi 7 me tekstin si në vijim:</p>	<p>keyword, phrase or other information, regardless of where or when the transactions are finally reached, the general information available in a specific section of the website that is directly and easily accessible from the website where the research results are presented, on the key parameters that determine the ranking of products presented to the consumer as a result of the search query and the relative importance of these parameters compared to other parameters, shall be considered as materials. This paragraph shall not apply to online search service providers.</p> <p>7. When a trader provides access to customer product reviews, information on whether and how a trader ensures that published comments come from consumers who have actually used or purchased the product shall be considered material.“</p> <p style="text-align: center;">Article 10</p> <p>Paragraph 3 of Article 17 is deleted.</p> <p style="text-align: center;">Article 11</p> <p>Paragraph 7 with the following texts shall be added to Article 33:</p>	<p>informacije, bez obzira na to gde ili kada transakcije konačno stižu, opšte informacije, dostupne u određeni deo internet stranice koji je direktno i lako dostupan sa stranice na kojoj su prikazani rezultati istraživanja, o ključnim parametrima koji određuju rangiranje proizvoda koji su predstavljeni potrošaču kao rezultat pitanja za pretragu i relativnu važnost ovih parametara, u odnosu na druge parametre, smatraće se materijalnim. Ovaj stav se ne odnosi na pružaoce usluga pretraživanja na internetu.</p> <p>7. Kada trgovac omogući potrošačima pristup recenzijama proizvoda, informacije o tome da li i kako trgovac obezbeđuje da objavljeni komentari dolaze od potrošača koji su zaista koristili ili kupili proizvod smatraće se materijalnim.“</p> <p style="text-align: center;">Član 10</p> <p>Član 17 stav 3 briše se.</p> <p style="text-align: center;">Član 11</p> <p>Članu 33 dodaje se stav 5 sa sledećim tekstom:</p>
--	--	--

<p>“7. Çdo njoftim i uljes së çmimit duhet të tregojë çmimin paraprak të aplikuar nga tregtari për një periudhë të caktuar kohe para aplikimit të uljes së çmimit. Çmimi paraprak nënkupton çmimin më të ulët të aplikuar nga tregtari gjatë një periudhe kohore jo më të shkurtër se 30 ditë para aplikimit të uljes së çmimit, përveç mallrave që mund të përkeqësohen ose skadojnë shpejt.”</p>	<p>“7. Any announcement of a price reduction shall indicate the prior price applied by the trader for a determined period of time prior to the application of the price reduction. The prior price means the lowest price applied by the trader during a period of time not shorter than 30 days prior to the application of the price reduction, exception for goods which are liable to deteriorate or expire rapidly.”</p>	<p>„7. Svako obaveštenje o sniženju cene mora da navede prethodno primenjenu cenu koju je trgovac primenio za određeni vremenski period pre primene sniženja cene. Prethodna cena znači najnižu cenu koju trgovac primenjuje u periodu od najmanje 30 dana pre primene sniženja cene, osim za robu koja može brzo da se pokvari ili istekne rok.“</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12</p> <p>KREU VII i ligjit bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:</p> <p style="text-align: center;">„KREU VII TË DREJTAT E KONSUMATORËVE NË RELACION ME KONTRATAT NË DISTANCË DHE JASHTË OBJEKTIT AFARIST”</p>	<p style="text-align: center;">Article 12</p> <p>CHAPTER VII of the basic law shall be deleted and rephrased as follows:</p> <p style="text-align: center;">„CHAPTER VII CONSUMER RIGHTS IN RELATION TO DISTANCE AND OFF-PREMISES CONTRACTS“</p>	<p style="text-align: center;">Član 12</p> <p>GLAVA VII osnovnog zakona briše se i preformuliše sledećim tekstem:</p> <p style="text-align: center;">„GLAVA VII PRAVA POTROŠAČA U VEZI SA UGOVORIMA NA DALJINU ILI IZVAN POSLOVNIH PROSTORIJA“</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13</p> <p>Në nenin 38 në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.5, 1.7. dhe 1.8 të ligjit bazë fshihen dhe riformulohen me tekstet si në vijim:</p> <p>1.5. Përveç njoftimit të ekzistencës së garancisë ligjore të konformitetit për mallrat, përmbajtjen digjitale dhe shërbimet digjitale, njoftimin dhe kushtet</p>	<p style="text-align: center;">Article 13</p> <p>Under Article 38, in paragraph 1, subparagraphs 1.5, 1.7, 1.8 of the basic law shall be deleted and rephrased with the following text:</p> <p>1.5. In addition to a reminder of the existence of the legal guarantee of conformity for goods, digital content and digital services, the existence and</p>	<p style="text-align: center;">Član 13</p> <p>1. U članu 38 stav 1 tačke 1.5, 1.7 i 1.8 osnovnog zakona brišu se i preformulišu sledećim tekstem:</p> <p>1.5. Pored obaveštavanja o postojanju zakonske garancije na usaglašenost za robu, digitalni sadržaj i digitalne usluge, obaveštenje i uslovi usluga nakon</p>

<p>e shërbimeve pas shitjes dhe garancitë tregtare, kur kjo është e zbatueshme.</p> <p>1.7. Aty ku është e aplikueshme, funksionaliteti, përfshirë masat e zbatueshme të mbrojtjes teknike, të mallrave me elemente digjitale, përmbajtje digjitale dhe shërbimeve digjitale;</p> <p>1.8. Aty ku është e aplikueshme, çdo përputhshmëri dhe ndërveprim i rëndësishëm i mallrave me elemente digjitale, përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale për të cilat tregtari është i vetëdijshëm ose mund të pritet që të ketë qenë i vetëdijshëm.</p>	<p>the conditions of after-sales services and commercial guarantees, where applicable.</p> <p>1.7. Where applicable, the functionality, including applicable technical protection measures, of goods with digital elements, digital content and digital services;</p> <p>1.8. Where applicable, any relevant compatibility and interoperability of goods with digital elements, digital content and digital services that the trader is aware of or can reasonably be expected to have been aware of.</p>	<p>prodaje i komercijalne garancije, ako je to primenjivo.</p> <p>1.7. Tamo gde je primenljivo, funkcionalnost, uključujući primenjive mere tehničke zaštite robe sa digitalnim elementima, digitalnim sadržajem i digitalnim uslugama;</p> <p>1.8. Tamo gde je primenljivo, svaka relevantna usaglašenost i interakcija robe sa digitalnim elementima, digitalnim sadržajem i digitalnim uslugama, za koje je trgovac svestan ili se očekuje da bude svestan.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14</p>	<p style="text-align: center;">Article 14</p>	<p style="text-align: center;">Član 14</p>
<p>1. Në nenin 39 në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.3, 1.6, 1.13, 1.19, dhe 1.20 të ligjit bazë fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:</p> <p>1.3. Adresa gjeografike ku është regjistruar tregtari, si dhe numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike të tregtarit; përveç kësaj, kur tregtari siguron mjete të tjera të komunikimit në internet që garantojnë që konsumatori mund të mbajë çdo korrespondencë me shkrim, duke përfshirë datën dhe kohën e një korrespondence të tillë me tregtarin në një medium të</p>	<p>1. Under Article 39, in paragraph 1, subparagraphs 1.3, 1.6, 1.13, 1.19 and 1.20 of the basic law shall be deleted and rephrased as follows:</p> <p>1.3. The geographical address at which the trader is established as well as the trader's telephone number and email address; in addition, where the trader provides other means of online communication which guarantee that the consumer can keep any written correspondence, including the date and time of such correspondence, with the</p>	<p>1. U članu 39 stav 1 stavovi 1.3, 1.6, 1.13, 1.19. i 1.20 osnovnog zakona brišu se i preformulišu sledećim tekstom:</p> <p>1.3. Geografska adresa na kojoj je trgovac registrovan, kao i broj telefona i adresa elektronske pošte trgovca; pored toga, kada trgovac obezbedi druga sredstva komunikacije na internetu koja osiguravaju da potrošač može održavati bilo kakvu pisanu korespondenciju, uključujući datum i vreme takve korespondencije sa trgovcem na stabilnom mediju, pri čemu informacije</p>

